



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3376/16 prot.,

Datë 09.02.2026

V E N D I M
Nr.223/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 134/2026, datë 26.01.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Përqendruara.sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Isometric” SHPK, me NIPT L92207009A dhe adresë: Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë: Bulevardi Bajram Curri, pallati Kastrati, Tiranë.

Operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, me NIPT M41406021N dhe adresë: Rr. Stavri Themeli, ZK 8220, vol.12, fq.23 me nr. Pasurie 8/307-N2, Tiranë

Autoritet Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e

rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 134/2026, ku vendosi:
[.....]

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, në zbatim të vendimit të KSHA nr.148/2025, datë 09.12.2025.*
3. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
4. *Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
5. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK dhe operatori ekonomik “BionicTech” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..” [...]

I.2. Me shkresën nr. 4251/33 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën nr. 3376/13 prot., datë 03.02.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 134/2026 datë 26.01.2026 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 02.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1.. Me shkresën nr. 4251/33 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën nr. 3376/13 prot., datë 03.02.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 134/2026 datë 26.01.2026 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 02.02.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 134/2026, datë 26.01.2026

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-63108-09-30-2025, me objekt: “Loti 5: “Blerje kolona kromatografike”, me fond limit 8,835,108.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

